



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (40 dhe neni 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-58 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-58 datë 21.02.2025, në pajtim me Konkluzionin,ark.nr.02-737/2 datë 24.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seanca e 8-të mbajtur më 24.02.2025, miratoj:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim në radio

NDALET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, PA 1 nr.08-100 datë 07.09.2023

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 7-të mbajtur më 18.02.2025, me Konkluzion ark.nr.02-657/13, datë 18.02.2025, miratoi propozimin e dr.Zoran Trajçevski, Drejtori i Agjencisë PA1 nr.08-58 datë 14.02.2025 ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, PA1 nr.08-100 datë 07.09.2023, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregull administrative, në Raportin me Shkrim ark.nr.05-666/1 datë 14.02.2025, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80, paragrafi (50 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë..

Lidhur me këtë, nga Agjencia me datë 19.02.2025, drejtuar transmetuesit në fjalë është dërguar Shkresë PA1 nr.08-58, datë 19.02.2025, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit



**Agjenci për shërbime
mediatike audio dhe
audiovizive**

**rr. Maqedonia nr 3 8
1000 Shkup
Republika e
Maqedonisë së Veriut**

tel. + 389 2 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk**



¹ Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë , shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

për inicimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 21.02.2025, drejtuar Drejtorit të Agjencisë nga Sektori për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.08-58 datë 21.02.2025 se SHTR GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, me datë 21.02.2025, ka kryer pagesë në shumë prej 23.182,00 (njëzet e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) denarë, me çka kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio e ka paguar në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10² të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe neni 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-58 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-58 datë 21.02.2025 në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-737/2 datë 24.02.2025, Këshilli i Agjencië, në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, vendosi të ndalon procedurën e inicuar për për heqjen e lejes.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshilla juridike : Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka rë drejtë padie për inicimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

² Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë , shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).